

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nën paragrafi 1.17 dhe neni 65 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 4, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 04/L-18 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 prill 2016, nxori këtë:

### **UDHËZIM Nr. 03/2016**

#### **Mbi procedurat e ndërprerjes, anulimit dhe zëvendësimit të policës së sigurimit nga autopërgjegjësia si dhe kthimit të primit të sigurimit për këto raste**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i procedurave për ndërprerjen, anulimin dhe zëvendësimin e policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, si dhe kthimin e primit për këto raste.
2. Ky udhëzim aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm, të cilët janë të licencuar për të ofruar sigurimin nga autopërgjegjësia.

##### **Neni 2**

##### **Ndërprerja e policës së sigurimit nga autopërgjegjësia**

1. I siguruari mund të ndërpresë policën e sigurimit nga autopërgjegjësia duke njoftuar paraprakisht siguruesin kur:
  - a) nuk realizohet regjistrimi i mjetit motorik;
  - b) mjete motorik çregjistrohet (ç' lajmërohet);
2. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, të siguarit i kthehet primi në proporcion me kohën e mbetur të kohëzgjatjes së policës, i llogaritur sipas parimit "pro rata temporis" në rast se nga polica përkatëse nuk është paguar dëm. Nga primi i mbetur, siguruesi mund të zbresë deri në 10% në emër të shpenzimeve të blerjes.
3. Në rast të mos regjistrimit të automjetit, për të cilin është dhënë polica e sigurimit nga autopërgjegjësia, të siguarit i kthehet primi sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni, duke kërkuar prej tij të dy kopjet e policës, deklaratën se në ndërkohë nuk i ka

shkaktuar dëm personit të tretë me atë automjet dhe dokumentin nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve për mos regjistrimin e automjetit.

4. Në rast të çregjistrimit të mjetit motorik, për të cilin është dhënë polica e sigurimit nga autopërgjegjësia, të siguruarit i kthehet primi sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni, duke kërkuar prej tij kopjen e policës, deklaratën se në ndërkohë nuk i ka shkaktuar dëm personit të tretë me atë automjet dhe dokumentin nga Qendra e Regjistrimit të Automjeteve për çregjistrimin e automjetit.

### **Neni 3**

#### **Zëvendësimi dhe ndërprerja me rastin e bartjes së pronësisë (ndërrimit të pronarit) të mjetit motorik**

Në rastet e bartjes së pronësisë (ndërrimit të pronarit) të mjetit motorik, gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, i kalojnë pronarit të ri dhe vlejnë deri në përfundimin e kontratës së sigurimit, nëse nuk është kontraktuar ndryshe. Pronari i ri brenda dhjetë (10) ditësh, detyrohet të njoftojë siguroesin për ndryshimin e pronësisë së mjetit motorik dhe pasqyrimin e këtij ndryshimi në kontratën e sigurimit. Organet përgjegjëse për regjistrimin e mjeteve motorike detyrohen të njoftojnë Byronë dhe Qendrën e Informativë për ndryshimin e pronësisë së mjetit motorik, brenda një periudhe prej dhjetë (10) ditësh kalendarike. Nëse i siguruari dhe pronari i ri i mjetit motorik, pajtohen që kontrata e sigurimit të mos bartet në pronarin e ri, pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit (dëshmi: kontrata), në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar dëmi.

### **Neni 4**

#### **Anulimi dhe zëvendësimi i policës së sigurimit nga autopërgjegjësia në rast të gabimeve teknike, humbjes dhe dëmtimeve fizike.**

1. Anulimi i policës së sigurimit TPL mund të bëhet vetëm në rast të gabimeve teknike, të cilat rezultojnë gjatë lëshimit të policës dhe të cilat kryesisht kanë të bëjnë me të dhënat për pronarin e automjetit, të dhënat teknike të automjetit, lartësinë e primit të kontraktuar, periudhën e sigurimit, TVSH-në dhe të dhënat tjera të cilat duhet t'i përmbajë polica. Periudha e sigurimit mbetet e njëjtë dhe i siguruari nuk ngarkohet me shpenzime për ndërrimin e policës. Anulimi i policës nga ana e agjentit mund të bëhet në afatin prej 24 orësh nga lëshimi i policës, ndërsa, pas këtij afati, anulimin mund ta bëjë vetëm Siguroesi.
2. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, i siguruari duhet që brenda (24 orëve) ta informojë me shkrim Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve duke ja dërguar të bashkëngjitur kopjen e policës valide në mënyrë, që kjo qendër të evidentojë validitetin e policës në dosjen e automjetit në vend të policës së anuluar.

3. Zëvendësimi i policës së sigurimit TPL mund të bëhet në rast të humbjes apo dëmtimit fizik të policës. Në rastin e humbjes së policës, i siguruari duhet të depozitojë pranë kompanisë dokumentin e paraqitjes në organet përgjegjëse për humbjen e dokumentit. Në rast të dëmtimit fizik të policës së sigurimit, i siguruari duhet t'i depozitojë te siguruesit policën e dëmtuar.
4. Në rastet e zëvendësimit të policës, i siguruari duhet që brenda (24 orëve) ta informojë me shkrim Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve duke ia dërguar të bashkëngjitur kopjen e policës valide në mënyrë, që kjo qendër të evidentojë validitetin e policës në dosjen e automjetit në vend të policës së zëvendësuar.

#### **Neni 5**

#### **Ndërprerja, anulimi dhe zëvendësimi i sigurimit të detyrueshëm kufitar të autopërgjegjësive**

Mënyra e ndërprerjes, anulimit dhe zëvendësimit të policës së sigurimit kufitar të autopërgjegjësive, do të bëhet në pajtim me rregulloret e nxjerra nga Byroja Kosovare e Sigurimeve.

#### **Neni 6**

#### **Ndërprerja, anulimi dhe zëvendësimi i policës së sigurimit TPL Kosova Plus**

1. Polica vendore e sigurimit nga autopërgjegjësia, paraqet bazë për policën TPL Kosova Plus.
2. Primi i policës TPL Kosova është 30% nga primi i policës vendore. Kjo policë mund të ndërpritet vetëm nëse ndërpritet polica vendore e autopërgjegjësive dhe në këtë rast mund të kërkohet edhe kthimi i primit të sigurimit TPL Kosova Plus.
3. Polica TPL Kosova Plus mund të blihet në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së policës vendore, kurse afati i skadimit të kësaj police është e lidhur me skadencën e policës vendore të sigurimit nga autopërgjegjësia.
4. Polica TPL Kosova Plus nuk mund të shitet për një afat më të shkurtër se afati i skadimit të policës vendore të sigurimit nga autopërgjegjësia dhe primi do të jetë 30% nga primi i policës vendore, i llogaritur sipas parimit “pro rata temporis”, por jo më pak se 15 euro. Edhe për këto polica duhet instaluar softueri përkatës, përmes të cilit bëhet lëshimi i tyre.
5. Përcaktimet e neneve 2, 3 dhe 4 të këtij udhëzimi aplikohen edhe për ndërprerjen, anulimin dhe zëvendësimin e policës së sigurimit TPL Kosova Plus.

**Neni 7**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi, do të shfuqizohet Udhëzimi i datës 13 dhjetor 2005 mbi procedurat e anulimit të policës, zëvendësimit të policës, ndërprerjes së sigurimit dhe kthimit të primit të sigurimit TPL dhe TPL Kosova plus.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.

  
Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv